

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Lutfi Haziri, Kryetar i Komunës së Gjilanit Shpresa Kurteshi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjilanit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 10/06/2019
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Gjilanit	020-652
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Konfirmimi i ligjshmërisë së Vendimit Nr. 016-60469 për shpalljen e interesit të ligjshëm publik për sigurimin e tokës për nevoja të realizimit të Projektit - Fabrika e Ujërave të Zeza (FUTZ) në zonën kadastrale Uglar
I miratuar më datë: 30.05.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.06.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi*** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Za:	Lutfi Haziri, gradonačelnik Opštine Gnjilane Shpresa Kurteshi, predsedavajuća Skupštine opštine Gnjilane	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenta u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 10.06.2019
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Gnjilane	Br.020-652
Vrsta akta:	Odluka	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvažena predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbe Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je zahtev za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravikao u nastavku:

Potvrda zakonitosti Odluke br. 016-60469 za proglašenje od opšteg interesa za obezbeđenje zemljišta za potrebe realizacije projekta - Fabrika fekalnih voda (FUTZ) u katarstarskoj zoni "Uglar"
Usvojena dana, 30.05.2019. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 07.06.2019. godine


Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u **skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvoditi pravni učinak.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za daljna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01 016-60464
30.05.2019



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilane
Gjilan Beledijesi

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d), LVL-së, me qëllim të zbatimit të kompetencave të deleguara në ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale për trajtimin e ujërave të zeza, të parapara me nenin 17, pika (f) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, implementimin e Planit Zhvillimor Komunal "Gjilani-2015+", e në mbështetje të nenit 4 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme për sigurimin e tokës për nevoja të realizimit të Fabrikës së Trajtimin të Ujërave të Zeza (FUTZ) në zonën Kadastrale Uglar, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në 30.05.2019, miraton këtë:

SEANÇEN E MBAJTUR ME DATË
07.06.2019

Ministria e Administrimit të Përbashkët Lokal
Ministerstvo Lokalne Samouprave / Administration
Ministry of Local Government Administration

07.06.2019

№	Lloji	Shifra	Titulli
01	016-60464		

V E N D I M

Për Shpalljen e Interesit të Ligjshëm Publik për sigurimin e tokës për nevoja të realizimit të Projektit - Fabrika e Ujërave të Zeza (FUTZ) në Zonën Kadastrale Uglar

1. Kuvendi i Komunës Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës nr.02-320 të datës 08.05.2019 për Shpalljen e Interesit të Ligjshëm Publik për shpronësimin e pronave të paluajtshme private në ZK Uglar për sigurimin e tokës për nevoja të implementimit të Projektit "Fabrika për Trajtimin e Ujërave të Zeza" (FUTZ) i cili mbështetet nga Qeveria e Kosovës, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (BERZH) dhe Banka Investuese Evropiane (BIE) kurse bartëse e këtij projekti është KRU "Hidromorava" Gjilan. Qëllimi i projektit është grumbullimi dhe trajtimi i të gjitha ujërave të zeza në zonën urbane të qytetit dhe fshatrat për rreth tij.

2. Interesi i Ligjshëm Publik shpallet për sipërfaqen tokësore prej 72505 m², nga e cila sipërfaqe për nevoja të impiantit sipërfaqja prej 69207m², kurse për nevoja të rrugës, sipërfaqja prej 3298 m².

2.1. Për nevoja të Impiantit Interesi Publik shpallet në këto ngastra kadastrale :

P-02063-0; P-02057-0; P-02056-0; P-01926-0; P-01925-0; P-02066-0; P-02068-0; P-02065-0; P-02064-0; P-02055-0; P-02052-0; P-02060-0; P-02059-0; P-02051-2; P-02058-0; P-02062-0; P-02051-1; P-02061-0; P-02075-0; P-02076-0; P-02077-0; P-02086-0; P-02087-0; P-02085-0; P-02078-0; P-02082-0; P-02083-0; P-02084-0; P-02088-0; P-02081-0; P-02073-0; P-02079-0; P-02080-0; P-02074-0; P-02069-0; P-02070-0; P-02071-0; P-02071-0; P-02072-0; P-02067-0.

2.2. Për nevoja të infrastrukturës - rrugës për qasje tek impianti, Interesi Publik shpallet në këto ngastra kadastrale:
P-3227-0; P-1878-0; P-1879-0; P-3237-0; P-1988-0; P-1982-0; P-1985-0; P-1980-0; P-1986-0; P-1973-0;
P-1972-0; P-1948-0; P-1939-0; P-1938-0; P-1928-0; P-1881-0; P-1886-0; P-1883-0; P-1887-0; P-1892-0;
P-1893-0; P-1894-0; P-1861-0; P-1880-0; P-1926-0; P-1925-0.

3. Ngastrat kadastrale të propozuara janë përzgjedhur për shpronësim sepse ato shtrihen në lokacionin i cili në bazë të Planit Zhvillimor Komunal "Gjilani 2015+" i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Gjilanit 01.nr.11736 i datës 30.10.2008, ka destinimin për ndërtimin e impiantit dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe nuk janë përzgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues.

4. Qëllimi i ligjshëm publik - ndërtimi i Fabrikës për Trajtimin e Ujërave të Zeza (FUTZ) nuk mund të arrihet pa kryerjen e shpronësimit dhe përfitimi publik është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga shpronësimi.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

7. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Nr.01.016-60469

Gjilan, më 30.05.2019

Kryesuesja e KK-Gjilan

/Skryesja Kurteshi- Emini/